

Gjyqtari i Gjykatës së Apelit të Tiranës, Gjin Gjoni ka dhënë dorëheqjen: Vettingu po i shërben politikës!

21 Korrik 2020 LAJME

Një nga emrat më të lakuar të drejtësisë shqiptare, gjyqtari i Gjykatës së Apelit të Tiranës, Gjin Gjoni ka dhënë dorëheqjen. Sipas mediave të ndryshme zoti Gjoni i ka drejtuar një letër KLGJ-së, në të cilën zbardhen dhe arsyet e dorëheqjes. Përmbajtja e letrës botohet prej tyre në mënyrë fragmentare. Sipas saj gjykatësi Gjoni vlerëson se procesi i vettingut është i pabarabartë dhe atë e kalojnë të gjithë ata që i shërbejnë politikës. “Drejtësia është në kolaps. Vettingu nuk zhvillohet njësoj për të gjithë. Vettingun e kalojnë vetëm ata që i shërbejnë politikës” citojnë disa media nga letra e zotit Gjoni. Në këtë letër ish gjyqtari Gjin Gjoni shkruan gjithashtu se “E vetmja mënyrë që ka mbetur për t’i shërbyer publikut është të dorëhiqem dhe të përballem në mbrojtje të interesit publik duke qenë në ballë të luftës për drejtësi, duke mos lënë padrejtësinë të marrë përpara këdo vetëm nga frika e “pushkatimit pa gjyq”. Momenti i dorëheqjes vjen ndërsa gjyqtari Gjin Gjoni ishte nën hetim administrativ nga KPK-ja. Afro dy vjet më parë Këshillit të Lartë i Drejtësisë, ka miratuar një leje dy vjeçare për gjyqtarin e Apelit të Tiranës Gjin Gjoni. Në atë kohë ai kërkoi 2 vjet leje me argumentimin se është bërë baba dhe do t’i duhet të bëjë shpesh udhëtime dhe vizita në shtetin gjerman ku jeton familja e tij. Ministrja Etilda Gjoni tha me këtë rast se vendimi është marrë në kundërshtim me ligjin duke akuzuar KLD-në se është bërë palë me ata që nuk e duan vettingun.